

Teuta Toska (1975–). Kërkuese në fushën e etnolinguistikës dhe filozofisë së gjuhës, në fushë të historiografisë së krishterimit në Shqipëri, pedagoge pranë departamentit të gjuhësisë në Fakultetin e Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani” (www.uniel.edu.al), që nga viti 2016 përgjegjëse e departamentit përkatës, anëtare e komitetit ekzekutiv të Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante (www.instituti.org). Ka kryer shkollën tetëvjeçare dhe të mesme pranë shkollës artistike “Onufri”, Elbasan, dega violinë. Mbaroi studimet në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani” (1997), në Fakultetin e Shkencave Humane, dega gjuhë-letërsi. Me mbarimin e studimeve të larta u emërua pedagoge e jashtme dhe pas një viti pedagoge me kohë të plotë pranë departamentit të gjuhësisë në këtë universitet. Ka kryer studimet e thelluara universitare (të nivelit “master”) pranë departamentit të gjuhës në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës, dhe më tej studimet doktorale, po aty, në fushën e frazeologjisë së shqipes, etnolinguistikës dhe filozofisë së gjuhës. Është doktoruar në vitin 2013 dhe ka marrë titullin “Profesor i asociuar” në 2015. Aktualisht jeton dhe punon në Elbasan. Teuta Toska ka një veprimtari akademike dhe shkencore, që përfshin kërkime në fushë të leksikologjisë, etnolinguistikës, studime letrare, çështje të standardit dhe kulturës së gjuhës, historiografisë së krishterimit, dhe ka veprimtari akademike mësimdhënëse në kurse, si: hyrje në gjuhësi, gjuhësi e përgjithshme, etnolinguistikë, filozofi e gjuhës, semiotikë, stilistikë e gjuhës shqipe. Zhvillon ligjërata si pedagoge me kohë të pjesshme edhe në Fakultetin Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës, për kursin “Gjuha shqipe dhe përkthimi”.

Ka qenë anëtare e bordit shkencor në organizimin e konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ka botuar 4 artikuj në revista shkencore kombëtare, 2 artikuj në revista ndërkombëtare, ka marrë pjesë me 29 kumtesa (të publikuara në aktet e konferencave) në seminare e konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Është autore e një monografie shkencore të botuar në vitin 2014.